



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 28 maj 2025

Z. Hekuran Murati, Ministër

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

LETËR REKOMANDIMI

Ex officio nr. 68/2025

Avokati i Popullit, në pajtim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore duke marrë për bazë një numër relativisht të madh të ankesave të pranuar nga qytetarët që kryesisht i përkasin komunitetit serb të parashtruara kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), për shkak të pezullimit të pagesës së shtesës për fëmijë, filloi një hetim sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Ankesat e pranuar në institucion janë regjistruara nën shifrat e regjistrimit si në vijim: (R. 1452/24 I.S., R. 1453/24 M.S., R. 21/25 M.S. R. 23/25 M.D., R. 36/25 I. G., R. 53/25 S.V., R. 54/25 M.M., R. 55/25 N.A., R. 59/25 M.S., R. 66/25 D.J., R. 69/25 B.R., R. 74/25 A.B., R. 75/25 N.K., R. 79/25 M.M., R. 89/25 A.I., R. 92/25 A.V.S. R. 94/25 M.M dhe të tjerët (ankesë kolektive me 34 ankues), R. 98/25 J.E., R. 99/25 D.V., R. 100/25 A.Š., R. 101/25 S.R., R. 116/25 D.R., R.114/25 M.M.S., R. 120/25 I.A., R. 121/25 N.T., R. 122/25 A.Š., R. 125/25 H.E., R. 133/25 I.M., R. 233/25 G.V., R. 235/25 K.M., R. 238/25 N.R., R. 239/25 M.M., R. 247/25 B.P., R. 270/25 M.P., R. 271/25 D.I.J, R. 302/25 M.S, R. 303/25 M.S., R. 304/25 A.M., R. 305/25 J.J.C., R. 306/25 V.C., R. 309/25 A.S., R. 310/25 H.A., R. 311/25 M.L., R. 312/25 Z.S., R. 314/25 M.D., R. 315/25 I.T., R. 317/25 M.S., R. 318/25 M.S., R. 356/25 N.K., R. 358/25 S.S., R. 359/25 R.M., R. 374/25 J.S., R. 376/25 N.K. R. 401/25 S.P., R. 420/25 U.S., R. 438/25 J.S.

Në mesin e ankesave të pranuar, një numër ankesash janë parashtruar nga qytetarët që brenda periudhës nga shtatori deri në fund të dhjetorit 2024, aplikuan për herë të parë për ta ushtruar të drejtën e përfitimit për fëmijë, të cilët pretendojnë se me rastin e aplikimit pranuan një mesazh nëpërmjet sistemit në platformën “e-Qeverisja” (e-Kosova) se aplikimi i tyre u pranua, mirëpo nuk pranuan ndonjë njoftim apo pagesë në emër të shtesës për fëmijë.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë për mosrespektimin e parimit të barazisë para ligjit, përkatësisht zbatimin jokonsekuent të Vendimit nr. 55, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 9 shtator 2021, mbi caktimin e kushteve dhe kritereve për zbatimin e pjesshëm të

Masës 3.5 - Shtesat për fëmijë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike (më tej në tekst: Vendimi nr. 55).¹

Rrethanat e rastit

1. Më 9 shtator 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës e miratoi Vendimin nr. 55 për zbatimin e Masës 3.5, që ka të bëjë me subvencionimin për familjet me fëmijë. Masa 3.5 u referohet përfitimeve në të holla për familjet që kanë fëmijë nga mosha 0 deri në 16 vjeçare.
2. Vendimi, mes tjerash, përcakton formën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm. Pika 6 e Vendimit përcakton dokumentet të cilat duhet të dorëzohen me rastin e aplikimit e që janë si në vijim:
 - certifikata e lindjes së fëmijës ose ekstrakti nga Regjistri Qendror Civil i Gjendjes Civile;
 - dëshmia që aplikuesi/ja është kujdestar ligjor i fëmijës;
 - konfirmimi bankar i xhirollogarisë së aplikuesit/es;
 - kopja e letërnjoftimit të aplikuesit/es.
3. Ankuesit njoftuan se kanë qenë përfitues të shtesës për fëmijë nga shtatori i vitit 2021 deri në fund të dhjetorit 2024. Mirëpo, në periudhën prej muajit gusht deri në muajin dhjetor të vitit 2024, Departamenti i Skemave Sociale (DSS) i MFPT-së, nëpërmes e-mailit u ka kërkuar atyre verifikimin e dokumentacionin për shtesën e fëmijëve, përkatësisht u ka kërkuar që ata ta ofronin faturën e energjisë elektrike jo më të vjetër se 3 muaj, vërtetimin nga shkolla që ndjek fëmija ose kopshti ose kartelën e vaksinimit për fëmijët që nuk ndjekin shkollën ose kopshtin. Njëkohësisht, brenda kësaj periudhe ka filluar edhe pezullimi i pagesës së shtesës për fëmijë.
4. Ankuesit me tej kanë njoftuar se ata kanë vepruar në përputhje me udhëzimet në e-mail, e kanë dorëzuar dokumentacionin, fillimisht përmes qendrave kompetente për punë sociale, e më pas përmes postës. Mirëpo, përkundër faktit se ata kanë vepruar në përputhje me udhëzimet, pagesa e shtesës për fëmijët është pezulluar dhe ata nuk kanë marrë njoftime apo shpjegime lidhur me çështjen.
5. Së fundi, disa ankues thanë se janë njoftuar përmes e-mailit se dokumentacioni që e kanë dërguar në procesin e verifikimit në MFPT nuk është i vlefshëm, pa specifikuar se cili dokumentacion nuk është i vlefshëm dhe se për këtë arsye është e nevojshme që ata të paraqiten në Agjencinë e Statistikave të Kosovës në Prishtinë për verifikimin e vendbanimit me praninë e të gjithë anëtarëve të familjes.

Veprimet hetimore të Avokatit të Popullit

6. Përfaqësuesit e Avokati i Popullit, në kuadër të hetimeve të pretendimeve ankimore, më 31 janar 2025 ka zhvilluar një takim me përfaqësuesit e DSS-së, me ç' rast kanë kërkuar informata lidhur me:
 - arsyet e procedurës së verifikimit;

¹ Vendimi nr. 55 i Qeverisë për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për zbatimin e Masës 3.5, i datës 9.9.2021; <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/2BB0E5A8-D238-49E1-AA4D-5B46F7707D55.pdf>

- kriteret për vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur nga ankuesit;
 - transparencën e procesit të verifikimit;
 - rolin dhe bazën ligjore për përfshirjen e Agjencisë së Statistikave të Kosovës në procesin në fjalë;
 - mundësitë e lehtësimit për qytetarët të procesit të verifikimit.
7. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, ndër të tjerash, janë njoftuar se procesi i verifikimit të përfituesve të shtesave për fëmijë ka filluar në shtator të vitit 2024. Është bërë e ditur se ndihma në fjalë nuk është hequr, por është pezulluar përkohësisht deri në përfundimin e procesit të vërtetimit dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga përfituesit.
 8. Zyrtarët e DSS-së kanë deklaruar se ky proces po zhvillohet me ngadalësi për shkak të numrit të kufizuar të stafit të angazhuar në verifikim, gjë që ka ndikuar në paraqitjen e vonesave.
 9. Është konfirmuar gjithashtu se disa përfituesve të shtesave për fëmijë nga komuniteti serb u është kërkuar të paraqiten pranë Agjencisë së Statistikave të Kosovës për ta verifikuar statusin e tyre të banimit. Kjo për arsye se dëshmitë e ofruara, siç janë vërtetimet nga shkollat që ndjekin fëmijët dhe të dhënat e vaksinimit, nuk njihen nga sistemi shtetëror. Këto shkolla nuk figurojnë në regjistrin zyrtar të institucioneve arsimore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), njësoj sikurse institucionet shëndetësore që kanë lëshuar certifikatat për vaksinim.
 10. Përfaqësuesit e DSS-së janë pajtuar me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit se qytetarët në fjalë po përballen me vështirësi të shumta për shkak të pamundësisë për ta verifikuar dokumentacionin e dorëzuar, si dhe për shkak të kërkesës për paraqitje fizike në zyrat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës në Prishtinë, për qëllime të regjistrimit dhe të konfirmimit të vendbanimit të tyre në Kosovë.
 11. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë kërkuar nga zyrtarët e DSS-së që t'u ofroreshin të gjitha kopjet e vendimeve dhe të udhëzimeve mbi të cilat bazohej puna e DSS-së në zbatimin e Masës 3.5, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe dokumentacioni përkatës lidhur me procesin e verifikimit të dokumenteve.
 12. Megjithatë, deri në hartimin e këtij raporti, Avokati i Popullit ende nuk i ka marrë dokumentet që i ka kërkuar. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) është drejtuar në shërbimin juridik të DSS-së, i cili, ndonëse i informuar për kërkesën, nuk e ka dorëzuar ende dokumentacionin e përmendur.
 13. Avokati i Popullit nuk ka marrë një përgjigje të qartë as lidhur me kriteret e përzgjedhjes së qytetarëve që janë dërguar për verifikim dhe nuk është ofruar ndonjë sqarim për bazën ligjore mbi të cilën është përfshirë Agjencia e Statistikave të Kosovës në këtë proces verifikimi.
 14. Avokati i Popullit vëren se MFPT-ja, më 31 tetor 2024, ka nxjerrë Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 55/2021, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 55-1/2021, me Vendimin Nr. 55-2/2021, me Vendimin Nr. 55-3/22/23 dhe me Vendimin 55-4/2024, përmes së cilit janë shtuar pikat si në vijim:

"1B. Përfitimi pas aplikimit, pa ju nënshtruar procesit të verifikimit për përmbushjen e kriterëve sipas këtij vendimi do të jetë i mundur vetëm për fëmijët për të cilët në momentin e aplikimit janë tre (3) muajsh ose më pak dhe kanë lindur në Kosovë.

1C. Për fëmijët të cilët në momentin e aplikimit kanë më shumë se tre (3) muaj ose të cilët kanë lindur në Kosovë, e drejta për përfitim sipas këtij vendimi, mundësohet vetëm pas konfirmimit të përmbushjes së kriterëve pas procesit të verifikimit.

1Ç. Pagesa fillon të realizohet pas përfundimit të procesit të verifikimit për përmbushjen e kriterëve sipas këtij vendimi."

15. Vendimi i lartpërmendur i 31 tetorit 2024 nuk mund të gjendet në faqet zyrtare të MFPT-së. Avokati i Popullit i është qasur këtij vendimi nëpërmes linqeve të portaleve në internet² dhe publikimit nga e-Kosova në Facebook.³

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

16. Në përputhje me mandatin e tij, Avokati i Popullit synon, ndër të tjerash, ta informojë MFPT-në me qëndrimin e vet në lidhje me çështjen që është objekt shqyrtimi, duke u bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
17. Në veçanti, qëndrimi i Avokatit të Popullit bazohet në të drejtat e fëmijës, qasjen në të drejtat themelore sociale, kushtet e përcaktuara për pagesën e shtesës për fëmijë sipas vendimeve të Qeverisë në kuadër të Masës 3.5, e cila në thelb ka mbështetjen e familjeve me fëmijë deri në moshën 16-vjeçare.
18. Vendimi nr. 55 të Qeverisë për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e Masës 3.5, parasheh qartë mënyrën, kushtet dhe kufizimet e paraqitjes së kërkesës për ushtrimin e së drejtës për shtesën për fëmijë, ndërsa në asnjë dispozitë të tij nuk parashikon verifikimin e dokumenteve, të cilat qytetarët kanë qenë të detyruar t'i ofronin me rastin e paraqitjes së kërkesës.
19. Ndërsa Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 55/2021, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 55-1/2021, me Vendimin Nr. 55-2/2021, me Vendimin Nr. 55-3/22/23 dhe me Vendimin 55-4/2024, i datës 31 tetor 2024, parasheh një proces të verifikimit të dokumenteve, por nuk përcaktohen dokumente shtesë, të cilat u janë kërkuar qytetarëve nëpërmjet e-mailit.
20. Gjatë hetimit të çështjes, Avokati i Popullit nuk ka arritur të pranonte apo të gjente në faqen zyrtare të MFPT-së vendimin e ndryshuar, të cilit i është qasur nëpërmjet rrugëve jozyrtare. Përveç kësaj, Avokati i Popullit nuk ka arritur të gjente ndonjë dokument zyrtar, që ka të bëjë me procesin e përmendur të verifikimit dhe të vërtetimit të dokumentacionit, apo ndonjë dokument tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer procesi i përzgjedhjes së qytetarëve, prej të cilëve është kërkuar ta verifikonin vendbanimin e tyre në Kosovë.
21. Kërkesa për dokumente shtesë, pastaj mosnjohja e këtyre dokumenteve nga MPFT-ja për shkak se vërtetimet e lëshuara nga shkollat që nuk funksionojnë në kuadër të sistemit të arsimit të Republikës së Kosovës si dhe mosnjohja e certifikatave të vaksinimit të lëshuara nga institucionet shëndetësore që nuk funksionojnë në kuadër të sistemit

² <https://reporteri.net/lajme/ndryshon-procedura-e-aplikimit-per-shtesa-per-femije/>

³ <https://www.facebook.com/photo/?fbid=968685885295536&set=a.447383390759124>

shëndetësor të Republikës së Kosovës, afektojnë të drejtat e fëmijëve të komuniteteve joshumicë, në veçanti afektojnë të drejtat fëmijëve të komunitetit serb.

22. Kërkesa për t'u paraqitur në Agjencinë e Statistikave të Kosovës në Prishtinë është një kërkesë e pabazuar në ligj. Përveç kësaj, kjo kërkesë vë një barrë joproporcionale mbi familjet me fëmijë, të cilëve u është pezulluar pagesa. Disa qytetarë nuk mund ta plotësojnë këtë kërkesë për shkak të distancës së largët dhe vështirësive financiare. Avokati i Popullit posedon informata që në disa vendbanime me shumicë serbe ka qytetarë që nuk janë regjistruar, jo sepse nuk kanë dashur, por askush nuk ka shkuar për t'i regjistruar. Për më tepër, Avokati i Popullit nuk ka arritur ta kuptonte përfshirjen e Agjencisë së Statistikave të Kosovës në këtë proces.
23. Megjithëse disa ankues kanë njoftuar se pagesat e tyre janë vazhduar pas vizitës në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (së bashku me tërë anëtarët e familjes), por nuk u është bërë pagesa në mënyrë retroaktive për periudhën kur nuk e kanë marrë shtesën për fëmijë. Gjithashtu, disa ankues na kanë informuar se kanë vazhduar të marrin shtesën për fëmijë vetëm për një fëmijë, edhe pse më herët kanë marrë për më shumë fëmijë.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

24. Një ndër parimet e sundimit të ligjit është ligjshmëria, sipas të cilës kërkohet që të gjitha veprimet e autoriteteve shtetërore duhet të bazohen në ligj dhe se ligjet duhet të jenë të qarta, të parashikueshme, të përgjithshme dhe të qasshme për publikun. Ky parim vlen edhe për vendimet e marra nga Qeveria, në rastin konkret edhe për vendimet dhe rregulloret që rregullojnë kushtet për ushtrimin e së drejtës për shtesat për fëmijët. Duke pasur parasysh faktin se MFPT-ja ka përcaktuar kushte shtesë për verifikimin e dokumentacionit, të cilat nuk përcaktohen me Vendimin nr. 55 dhe as me ndryshimin dhe plotësimin e tij dhe duke marrë parasysh se këto kushte nuk mund të gjenden të publikuara, Avokati i Popullit konstaton se veprimet e tilla shkelin parimin e ligjshmërisë.
25. Një parim tjetër i sundimit të ligjit është siguria juridike, sipas së cilës kërkohet që individët duhet të jenë të mbrojtur nga ndryshimet e papritura dhe arbitrare të ligjit. Ky parim po ashtu vlen edhe për vendimet e marra nga Qeveria, në rastin konkret edhe për vendimet dhe rregulloret që rregullojnë kushtet për ushtrimin e së drejtës për shtesat për fëmijët. Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit nr. 55, i datës 9 shtator 2021, me një vendim të datës 31 tetor 2024, i cili nuk mund të gjendet i publikuar dhe i cili nga versionet jozyrtare që Avokati i Popullit ka arritur t'i gjente, përcakton një proces verifikimi, megjithëse nuk ofron detaje rreth këtij procesi, gjë që ndikon negativisht në sigurinë juridike të qytetarëve. Ky ndryshim në veçanti ndikon në të drejtat e qytetarëve nga komunitetet joshumicë, të cilëve nuk u njihen dokumentet dhe të cilëve u është kërkuar që të paraqiteshin në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, përfshirja e së cilës mbetet diskutabile, sepse nuk është bërë e qartë se cili është roli i kësaj agjencie në të drejtën e fëmijëve në shtesa.
26. Ndalimi i arbitraritetit po ashtu paraqet një ndër parimet e sundimit të ligjit. Sipas këtij parimi, autoritetet publike nuk duhet të veprojnë në mënyrë arbitrare apo t'i tejkalojnë kompetencat e tyre. Në rastin konkret arbitrariteti konsiston në faktin se MFPT-ja ka kërkuar dokumente shtesë që nuk përcaktohen me vendime apo me ndonjë dokument tjetër. Avokati i Popullit konsideron se veprimet e autoriteteve, të cilat nuk janë të

bazuara në ligj, shpien në arbitraritet. Ndërsa, për sa i përket tejkalimit të kompetencave, Avokati i Popullit konstaton se autoritetet administrative nuk do të duhej të vendosnin masa apo të ndërmerrnin veprime që nuk u përkisnin. Për autoritete administrative, në rastin konkret do të mjaftonte një certifikatë e lindjes, që dëshmon se fëmija ka lindur në Kosovë. Vërtetimi i faktit nëse fëmija jeton në Kosovë do të mund të dëshmohej me një provë shtesë të parashikuar me vendim. Po ashtu, është e nevojshme që të bëhet e ditur se shtesat e fëmijëve i gëzojnë vetëm fëmijët që kanë lindur dhe që jetojnë në Kosovë. Ndërsa nëse ekzistojnë dyshime të bazuara për keqpërdorim të përfitimeve sociale, atëherë autoritetet administrative do të duhej të nxirrnin vendime individuale dhe të arsyetuara, që mund të ishin objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe jo me një pezullim për një numër të madh të përfituesve dhe pa informata se mbi çfarë baze është bërë ky pezullim.

27. Sundimi i ligjit është i lidhur ngushtë me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Respektimi i të drejtave themelore të njeriut paraqet edhe një ndër parimet e sundimit të ligjit. Avokati i Popullit konsideron se veprimet e MFPT-së kanë mundur të mos kenë për qëllim shkeljen e të drejtave të qytetarëve që i përkasin komuniteteve joshumicë, por i gjithë procesi i verifikimit në rend të parë ka qenë në kundërshtim me parimet e procedurës administrative, gjë që ka pasur një efekt zinxhiror në shkeljen e parimeve të sundimit të ligjit, në të drejtat e komuniteteve joshumicë, në veçanti të fëmijëve të komunitetit serb, duke i vënë ata në një pozitë të pabarabartë dhe të pafavorshme.
28. Vendimi i Dhomës së Madhe i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (2007)* paraqet një vendim model, në të cilin gjykata qartësoi dhe forcoi një sërë parimesh që lidhen me barazinë në kontekstin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Është hera e parë që gjykata ka konsideruar një model diskriminimi mbarëkombëtar. Për më tepër, gjykata sqaron se në rastet kur një politikë ka një ndikim diskriminues, ekzistenca e qëllimit diskriminues nuk është relevante (diskriminim i tërthortë).
29. Në rastin konkret, shkelja e të drejtave të njeriut më së shumti afekton fëmijët e komuniteteve joshumicë, që në fakt përbën diskriminim mbi bazën e përkatësisë etnike, pasi fëmijët e këtyre komuniteteve i vijnë shkollat të cilat pa fajin e tyre nuk njihen nga autoritetet e Republikës së Kosovës ose që janë vaksinuar në institucione shëndetësore, të cilat pa fajin e tyre nuk njihen nga autoritetet e Republikës së Kosovës.
30. Avokati i Popullit, duke iu referuar edhe legjislacionit përkatës për të drejtat e fëmijëve, e konsideron se gjithmonë duhet të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës, ashtu siç e kërkon Kushtetuta dhe Konventa për të Drejtën e Fëmijës.
31. Neni 2 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës përcakton:
 1. *Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfaqësohet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paafësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.*
 2. *Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për*

shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

32. Ndërsa Neni 3, paragrafi 1, i Konventës përcakton:

“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”

33. Prandaj Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Departamentit për Skemat Sociale:

- 1. Pa vonesa të mëtejshme, të gjitha vendimet, udhëzimet dhe kushtet në lidhje me procesin e verifikimit të dokumentacionit të qytetarëve përfitues të shtesës për fëmijë të publikohen në mënyrë të qartë dhe transparente, në të dyja gjuhët zyrtare, në mënyrë që qytetarët të informohen pa pengesa për këtë proces.*
- 2. Të gjenden modalitete të përshtatshme për verifikimin e përmbushjes së kritereve, duke u dhënë mundësi të gjithë qytetarëve që me lehtësi dhe përmes dokumenteve, që mund t'i sigurojnë pa pengesa, të arrijnë ta dëshmojnë ekzistimin e kritereve që kërkohen.*
- 3. Të gjithë ata qytetarë, të cilët kanë aplikuar për herë të parë për shtesa për fëmijë, dhe qytetarëve të cilëve kjo shtesë u është pezulluar, t'u ofrohen vendime individuale të arsyetuara, në pajtim me parimet e procedurës administrative.*
- 4. Çdo përfituesi, të cilit i është pezulluar pagesa e shtesës për fëmijë, pas verifikimit, t'i paguhen në mënyrë retroaktive të gjitha pagesat që kanë mbetur të papaguara, përfshirë edhe shumën prej 100 eurosh, që u është dhënë në fund të vitit 2024 përfituesve të shtesave për fëmijë, të cilëve ky përfitim social nuk u është pezulluar edhe prindërve që kanë aplikuar për shtesa për fëmijë, por që nuk e kanë marrë atë deri më sot.*

Në përputhje me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

Kopje: Z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë
Zyra e Kryeministrit